FATOS KONGOLI

# LËKURA E QENIT

roman

*botimi i nëntë*

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2018

Botimi i parë : *maj 2003*
Botimi i dytë : *mars 2004*
Botimi i tretë : *shkurt 2005*
Botimi i katërt : *nëntor 2006*
Botimi i pestë : *korrik 2010*
Botimi i gjashtë : *tetor 2011*
Botimi i shtatë : *shtator 2012*
Botimi i tetë : *tetor 2014*
Botimi i nëntë : *prill 2018*

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Korrektore letrare: Arlinda Rrushi
Përkujdesja grafike: Elida Stafa

ISBN 978-9928-235-83-1

© Autori *dhe* Sh. B. Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë
Tel.: + 355 4 22 40 116
E-mail: redaksia@toena.com.al
botimet.toena@gmail.com
Http://www.toena.com.al

*Lilit,*
*bashkëshortes sime*

# 1

Praninë e Hadit-Hadesi i grekëve të lashtë ose Plutoni i romakëve - e vura re kur u sëmur Marga, gruaja ime. Më saktë ish-gruaja ime sepse ajo ka vdekur, po mbush një vit që ka vdekur. Ai, sigurisht, nuk ishte perëndia mitologjike e grekëve apo romakëve të lashtë. Ishte një person i rëndomtë nga raca jonë e krijesave kalimtare në këtë botë dhe mua nuk më kujtohet mirë se kur e në ç'rrethana e quajta me këtë emër. Mbase më ndodhi ta quaja kështu për shkak të asaj që përcaktohet si shoqërim idesh. Gjithçka qe një shoqërim idesh, asgjë më shumë.

Ndërkaq dëgjoj të thuhet se edhe Hadi ka vdekur. Unë nuk e shoh më në vendin e tij të përhershëm, nuk ndiej më vështrimin e tij, as të qeshurën e zezë. Por nuk i besoj ato që thonë. Thashethemi sipas të cilit ai paskej vdekur gjatë mungesës sime duhet të jetë një dredhi për të më prishur mendjen, për të më futur në kurth. Kjo pak a shumë do të thotë që në murin e lajmërimeve te rrugica që të çon prapa pallatit ku banoj, të ngjitet fleta me njoftimin e vdekjes sime.

E shoh, po ngatërrohem. Dua të rrëfej një histori dhe pa dashur po e bëj lëmsh. Më keq akoma, po e nxij. Dhe, dihet, gjërat e ngatërruara, për më tepër të

nxira, nuk i do njeri. Do të ishte e arsyeshme, pra, ta nisja me diçka më të qartë, pa ndërlikime, fjala vjen me diçka për veten. Kështu ndoshta ndjekja e kësaj historie, që u hap në mënyrë jo fort premtuese me vdekjen e Margës dhe të quajturin Had, do të ishte më e lehtë. Mundësisht komike. Aq sa njerëzit të shqyheshin gazit, të shqyhem dhe unë bashkë me ta.

Më quajnë Krist Tarapi. Emri im u kujtonte njerëzve Krishtin dhe, siç dihet, dikur, jo shumë larg, te ne Krishti ka qenë një personazh i shpallur armik. Shënoj se megjithë shpalljen armik të Krishtit, emri nuk më ka hapur telashe. Ishte vetëm një emër dhe unë, në sjelljet dhe veprimet e mia nuk kam pasur asgjë prej Krishti, pra nuk mendoj se paraqisja ndonjë rrezik. Përkundrazi, sado e çuditshme të duket, problematik për mua ka qenë mbiemri. Jam përpjekur shpesh t'i gjej një domethënie, por askush nuk ishte në gjendje të ma shpjegonte. Domethënien në një farë mënyre e gjenin dashakeqët e mi. Ata kishin një prirje për ta thjeshtuar mbiemrin tim dhe nga Tarapi e kthenin në Trapi. Edhe sot e kësaj dite ka njerëz që plot mirësjellje më thërrasin "zoti Trapi!"

Nuk e di nëse ky shtrembërim tekefundit përmbante një të vërtetë, pra një shkallë trapllëku timin, nëse më lejohet të shprehem kështu. Por, meqë unë dua të tregoj një histori, paraprakisht po kërkoj falje. Këtë nuk e bëj nga ndonjë lloj kompleksi, që e ka burimin te shtrembërimi i mundshëm i mbiemrit tim. Arsyeja është më praktike: kur kërkon t'u thuash të tjerëve diçka, me një fjalë t'u harxhosh gjënë më të çmuar, kohën, ka të ngjarë që me naivitetin tënd, mbase me budallallëkun, t'i mërzitësh. T'i lëndosh e, më tej, të dalësh edhe vetë në dritë të keqe. Mua nuk më tremb

gjasa se mund të dal në dritë të keqe. Sipas dëshirës, e mira dhe e keqja marrin kuptime relative. Ndërsa sipas një filozofie të lashtë që njerëzit e kanë shpikur për t'u vetëngushëlluar në rrethana të caktuara, e mira nuk është gjithnjë e mirë, e keqja nuk është gjithnjë e keqe. Ka të mira që vijnë për keq, ka të këqija që vijnë për mirë. Siç është rasti i aventurës sime të fundit. Sepse unë sapo jam kthyer nga një aventurë.

Ata që më njohin nuk do të habiten nga ky pohim. Do të vënë buzën në gaz, do t'u shkojë mendja te nofka ime. Trapi, do të thonë, sidomos kur të mësojnë motivin që më shtyu të futesha qorrazi në një labirinth ngjarjesh ku nuk e dija ç'më priste. Por unë isha i sigurt se çfarëdo që të më ndodhte do të ishte më e mirë se vdekja ime e përditshme. Kjo më bën të heq dorë edhe nga dredhitë e kota, fjala vjen nga orvatja për të ngatërruar gjurmët me paralajmërimin klasik se gjithçka në këtë histori është trillim i fantazisë. Nuk ka pikë kuptimi një paralajmërim i tillë. Zakonisht ai ka një qëllim të vetëm: të shërbejë si alibi për të fshehur të kundërtën. Unë marr përsipër të garantoj se i vetmi personazh që absolutisht nuk është trillim i fantazisë, ku nuk ka asnjë përputhje ose ngjashmëri të rastit e që fatkeqësisht më del në krye të rrëfimit, megjithë dëshirën time për ta shmangur, është Hadi.

# 2

Sëmundjen e saj, kur, siç thashë, m'u shfaq Hadi, Marga ma bëri të ditur në rrethana aspak dinjitoze për mua. Ishte fillimi i shtatorit '99, vjeshta e fundit e mijëvjeçarit të dytë. Rruzulli priste ndërrimin e epokave, gjashtë miliardë banorët e Tokës – nuk e di shifrën e saktë – pavarësisht profecive ogurzeza të Nostradamusit, i përgatiteshin çastit të afërt magjik.

Tërë natën kisha parë ëndrra erotike. Prej disa kohësh shihja ëndrra erotike. Çrregullimet e mia duhet të kenë nisur pas një nate të nxehtë vere kur Marga, tek bënim ose rrekeshim të bënim seks, e mërzitur dhe pa e përballur dëshirën time, më tha se i vinte keq, ajo nuk ndjente më asgjë e unë përpiqesha më kot ta sillja në qejf. Nuk e kapa menjëherë domethënien e pohimit të saj, nuk desha ta pranoja. Ndërsa Marga sikur mezi e kishte pritur atë çast, të shpëtonte një herë e mirë nga unë. Më pas ajo nuk pranoi kurrë të bënim seks, tani je i lirë, më thoshte, bëj ç'të duash, s'kam kurrfarë xhelozie. Mirëpo, kuptohet, tashmë isha i lirë vetëm për një gjë: të shihja ëndrra erotike. Në mjedisin tonë, ku nuk mbetet asgjë pa u marrë vesh, lapërdhitë vështirë t'i faleshin një cjapi si unë, në moshën pesëdhjetë e pesë vjeçare, me

djalin e madh të martuar dhe një vajzë studente. Për më tepër, të vetëndjerit gjysh-im bir ma dha shumë shpejt këtë kënaqësi duke u martuar mjaft i ri e duke nxjerrë në dritë dy fëmijë njëri pas tjetrit-më zhyti në një humnerë impotence seksuale.

Kështu dhe atë natë kur, ndaj të gdhirë, Marga më njoftoi sëmundjen e saj: po shihja një nga ëndrrat erotike më intensive të atyre kohëve, duke bërë seks me një mike të afërt të vajzës sime. Turp, lajthitje të tilla njeriut nuk i lejohen as në ëndërr. Duhet pranuar, edhe ëndrra më e çmendur ka diçka të vërtetë. Siç është e vërtetë, për shembull, që Lori, mikesha e adhuruar e vajzës sime, nuk kalonte pa më tronditur sa herë vinte te ne, e unë bëja çmos të mos e shihja në sy, ndryshe do ta kisha të vështirë ta fshihja turbullimin tim të turpshëm. Fajtor, dyfish fajtor, para Margës dhe para Irmës, kështu quhet vajza ime.

Lori nuk më thërriste as xhaxha, as me ndonjë nofkë tjetër, por thjesht në emër. Në emër më thërriste edhe ime bijë çka, të them të drejtën, nuk më mërziste, ndërsa Marga nuk e gëlltiste dot këtë lloj snobizmi të tyre. Duke u nisur nga sytë blu dhe bardhësia e lëkurës, ngjyra natyrore e flokëve të Lorit duhej të ishte pak a shumë e verdhë. Por kjo nuk mund të thuhej me siguri. Një ditë ajo u shfaq në kuadratin e derës gati e tëra në ngjyrë vishnje, që nga flokët, xhaketa prej lëkure, çizmet e gjata me taka të larta ngjitur pas këmbëve, deri tek aroma e trupit të saj, një aromë vishnjeje, siç m'u duk. Atë ditë në shtëpi nuk ndodhej as Marga, as Irma. Megjithatë Lori u fut brenda si në shtëpi të vet, më duhet të bëj një telefon, tha, dhe vajti në dhomën e pritjes ku mbanim telefonin, ngriti receptorin, formoi një numër. Unë

kisha mbetur te dera e dhomës i hutuar. Ky hutim, kur ndoshta për herë të parë ndodhesha vetëm për vetëm me atë dreq vajze, më zbuloi bishën agresive të strukur brenda meje. Bisha nuk kishte ngordhur, siç kujtoja. Bisha qe gjallë. Sytë e saj shihnin format e trupit të Lorit, e përpinin. Tjetra fliste me zë të ulët, këpuste ndonjë batutë, të lutem mos flit gomarllëqe, i tha tërë seriozitet dikujt, këtu është dhe Kristi, babai i Irmës, po dëgjon gomarllëqet e tua e kushedi ç'thotë me vete.

Unë as dëgjoja as thoja gjë me vete. I shpërqendruar dola në korridor, nga korridori jashtë, te dera e apartamentit, si të doja të rrija sa më larg saj për të qetësuar bishën brenda meje. Pastaj edhe ajo doli në korridor. Me aromën vishnjë të kurmit. Me buzët vishnjë që puthën faqen time para se të largohej nëpër shkallë. Duke më lënë me ndiesinë trullosëse të gjinjëve të saj që ishin mbështetur lehtë mbi gjoksin tim. Pa dyshimin më të largët se brenda meje kishte zgjuar një bishë. Pa e marrë me mend se që nga ajo ditë do të vinte rregullisht të më trazonte në ëndrrat e mia erotike.

Kështu, pra, edhe atë natë kur Marga më njoftoi për sëmundjen e saj. Po flija me Lorin në një akt të mundimshëm seksual, derisa realizova një orgazëm vishnjë. Atë çast hapa sytë dhe ndjeva një dënesë. Tej dritares po zbardhte. Qëndrova pa lëvizur, i shtrirë në brinjë: po dëneste Marga. Heshturazi. Si të trembej mos më zgjonte. Në fillim, ende nën pushtetin e ëndrrës, mendova se ndoshta, në përpjekjet virtuale për të depërtuar Lorin kisha rënkuar nëpër gjumë duke përmendur emrin e saj dhe Marga qante për shkak të çmendurisë sime. Pak minuta më vonë nuk

e durova dot më dënesën, zgjata dorën, e preka. Ajo u drodh. U kthye nga unë dhe mërmëriti diçka që truri im mezi e zbërtheu. Jam sëmurë, tha, do të vdes.

Këto fjalë Marga i shqiptoi me sigurinë e zakonshme të rasteve të njohura për mua kur fliste tepër seriozisht. Megjithë banalitetin tim të atyre çasteve, nuk kisha ndonjë arsye të mendoja se ajo, ende pa hapur sytë, kërkonte të bënte një shaka të rëndë. Mirëpo pohimi i saj i papritur qe aq i pamëshirshëm, ndërsa unë në një gjendje aq të vajtueshme, sa qesha me zor. Nuk parashikohet në mënxyrat e Nostradamusit, i thashë dhe ia kalova dorën midis flokëve. Nostradamusi nuk e ka parashikuar diçka të tillë... Ajo u ngrit ndenjur. Kam nisur të dyshoj një vit më parë, foli. Tani nuk mban më, duhet të shkoj në spital.

Desha të këmbëngulja me shakanë hipokrite të Nostradamusit por kjo do të ishte një poshtërsi ndaj Margës. Atëherë, nën dritën e dobët të agut, pashë rrënimin e fytyrës së saj. Tani, kur i kujtoj ato çaste, mund të bëj një pohim të çiltër: Margën e kisha dashur tërë jetën, asnjë grua tjetër nuk e kishte zënë dot vendin e saj. Do të kishte qenë e arsyeshme t'ia thosha këtë. Nëmos atë mëngjes, në ditët e mëpastajme. T'i betohesha se ndryshe nga ç'mund të kujtonte ajo, ndryshe nga ç'mund të mendonin shumë të tjerë, nuk kisha dashur ndonjë grua siç kisha dashur atë. Por unë nuk i thashë gjë Margës as atë mëngjes, as në ditët e mëpastajme. Dhe nuk e kuptoj përse më kafshojnë brenga të tilla tani, kur ajo nuk është më. Të thuash se kërkoj të shfajësohem para kushedi se kujt. Të thuash se frika nga një gjyq i mundshëm më ka hyrë aq keq, sa me pohime të tilla kërkoj të fitoj një çertifikatë mirësjelljeje.

Unë e kam ditur gjithmonë portretin që më bënin të tjerët: një aventurier me tru sa të peshkut. Njerëzve si unë, megjithatë, fati u jepkej vërbërisht ca dhurata të pamerituara. Në rastin tim, për shembull, një grua të mrekullueshme. E kjo grua e mrekullueshme, në rastin tim, paskej vajtur dëm si gjalpi në lëkurë të qenit. Kështu thoshin. Unë, pra, isha lëkura e qenit!

Hadi m'u shfaq atë ditë, kur gatiteshim të dilnim nga shtëpia me Margën për të vajtur në spital dhe unë po ndihesha si lëkurë qeni. Marga nuk deshi ta zgjonim Irmën. Nuk deshi t'i linim ndonjë shënim. Të shtunave, dhe atë ditë qe e shtunë, Irma nuk shkonte në fakultet, s'kishte leksione. Të shtunave paradite ajo plotësonte pagjumësinë e një jave të tërë. Për t'u mbrojtur nga dielli Marga mori një çadër, unë vura një kasketë strehëgjërë me shenjën e Nju Jorkut. Kasketën ma kishte çuar nga Amerika im bir. Ai ndodhet prej pesë vjetësh në Shtetet e Bashkuara, në Nju Jork, emigrant ekonomik, si fitues i llotarisë amerikane. Punon në aeroportin J.F. Kenedi dhe e quajnë Tomi. Jo se ka lindur në ditën e Shën Thomait. Unë dhe Marga nuk e çanim kokën për shenjtorë. Ato kohë shenjtorët tanë ishin të tjerë. I Margës ishte italiani Xhani Morandi. Imi, anglezi Tom Xhons. Kur lindi Tomi, njëzet e tetë vjet të shkuara, e hodhëm në llotari dhe fitoi shenjtori im. Nuk kam qenë ndonjëherë tek ai në Amerikë, as ai nuk kishte ardhur të më shihte deri sa vdiq Marga. Fatmirësisht kjo kishte qenë tek ai dy vjet të shkuara gjatë verës.

Poshtë pallatit tonë, nga ana e përparme, matanë një rruge tërë gropa ku qysh herët në mëngjes lëvrijnë makina, hapet një shesh në formë katërkëndëshi. Nuk e di të ketë patur ndonjë emër ky shesh. Në dy anë ai

rrethohet me pallate, në dy anë të tjera nga rrugë që kryqëzohen. Para disa vitesh atje kishte vetëm një lulishte. Në mes të lulishtes, mbi një piedestal mermeri, ngrihej një shtatore, kopje në përmasa të zvogëluara e shtatores gjigante në qendër të kryeqytetit, përbri Muzeut Historik. Sipas disave, shtatorja e sheshit në fjalë nuk ishte po ajo e sheshit para muzeut. Sipas tyre këtu ishte vendosur krenarisht shtatorja e Stalinit. Sipas disa të tjerëve, ajo e Haxhi Qamilit. Ndërsa një pjesë jo e vogël njerëzish ngulin këmbë se aty ka qenë Marksi. Në këto kushte po e quaj thjesht shtatore, pa emër.

Një ditë, një turmë e egërsuar me krekosjen fodulle të shtatores, e hoqi prej andej. E rrëzoi, e tërhoqi zvarrë rrugëve të lagjes. Kjo ndodhi në të njëjtën ditë, në të njëjtën orë, në të njëjtën minutë, kur një turmë tjetër e egërsuar, shumë më e madhe në përmasa, njëmijë fish nga ç'ishte më e madhe shtatorja e sheshit qendror krahasuar me shtatoren e sheshit tonë periferik, e tërhoqi atë zvarrë nëpër kryeqytet. Por kjo histori tashmë është harruar. Për disa kohë, sheshi ynë mbeti vetëm me lulishten dhe piedestalin bosh. Më pas, jo shumë larg piedestalit, dikush ngriti një kioskë, zuri të shiste hamburger, byrekë e pije freskuese. Si vuri mjaft para duke shitur gjëra të tilla – gojët e liga thoshin se ato shërbenin si mbulesë e një tregtie të dyshimtë, ku përziheshin dhe përfaqësues të rendit – ky ua mbathi në Kanada. Para se t'ua mbathte, kioskën ia paskej shitur dikujt tjetër e ky tjetri e zmadhoi, e mbuloi me tendë, krijoi një rrethim me parmakë e zinxhirë, vuri karrike, brenda dhe jashtë, e ktheu në pijetore. Për të prishur syrin e keq, pijetores i vuri emrin "Piedestali bosh". Në të vërtetë, ja sepse

pak më tutje ishte një stacion autobusi, pra një pikë me lëvizje, ja sepse shumë shpejt u bë qendra më tërheqëse për të gjithë meshkujt e ngeshëm të lagjes, pijetorja rrinte vazhdisht plot.

Dritarja e dhomës sime, në katin e tretë, binte nga ana e sheshit. Prej andej gjithçka dukej si në pëllëmbë të dorës. Atë mëngjes të tmerrshëm, para se të ngrihej nga shtrati, Marga m'u lut të mos e shihja në trup. Për të qenë e sigurtë më urdhëroi të shkoja pranë dritares, t'i ktheja shpinën derisa të merrte në komo ndërresat që i duheshin e të futej në banjë. Iu binda, vajta pranë dritares.

Sapo kishte aguar dhe në atë orë ishte ende shpejt që meshkujt e ngeshëm të lagjes apo kalimtarë të rastit të mbushnin tryezat dhe karriget e pijetores "Piedestali bosh". Kjo është arsyeja që mua më ra në sy diçka tepër e çuditshme. Nëse pijetorja qe bosh, pjesa tjetër e sheshit, prapa saj, qe plot. Një turmë burrash kishin zënë vend s'dihej qysh kur në ndenjëset prej betoni nën degët e pemëve-rrepe dhe eukalipte që, me të dalë dielli, krijonin një hije të dendur. Në përgjithësi ata ishin pensionistë me kapele republike ose me kasketa për t'u mbrojtur nga dielli. Rrinin grupe-grupe dhe nga lartësia e dhomës vura re se disa mbanin nëpër duar letra bixhozi, disa gurë dominoje, disa qenë përkulur mbi fushat e shahut, të tjerë mbi fushat e tavllës dhe të gjithë, pa përjashtim, në xhepat e këmishave apo xhaketave, kishin gazeta. Mirëpo ata nuk lëviznin. Ata rrinin si të ngrirë, m'u duk sikur kishin tërë natën që rrinin atje si të ngrirë. U enda nëpër dhomë, ua vura veshin lëvizjeve të Margës në banjë, pastaj, pa i bërë ballë kureshtjes, vajta zura vend edhe një herë pranë dritares: turma e burrave

vazhdonte të ndodhej atje, në pozicionin e ngrirë. Bashkë me ta zbulova Hadin.

Ai po rrinte në këmbë sipër shkallëve të mermerta, në një pozë prej shtatoreje, me njërën dorë të mbështetur te piedestali bosh, të thuash se sapo ishte rrëzuar prej andej dhe kërkonte të ngjitej prapë, me krahun të shtrirë në një drejtim të papërcaktuar të hapësirës. Koka e tij lëvizi ngathtësisht. I tronditur u largova nga dritarja. Marga doli nga banja dhe unë u shkëmbeva me të në korridor. Pa guxuar ta shihja në sy, u futa në banjë. Mbylla derën, shtrëngova tëmthat fort, çka më bëri mirë, ndryshe nuk do ta përballoja ngasjen për të vajtur në dritaren e banjës e të shihja edhe një herë nëse te sheshi i lokalit "Piedestali bosh", turma e burrave të ngurtësuar vazhdonte të gjendej nën degët e pemëve dhe ai, Hadi, shtatlartë e ceremonial, rrinte në atë pozën si të donte të ringjitej në piedestal, me dorën e zgjatur drejt një pike të papërcaktuar të hapësirës. Në të vërtetë, dora e tij tregonte një drejtim shumë të qartë, nga lindja, ku gjendeshin Varrezat, por edhe këtë e kuptova më vonë. Aty për aty shtrëngimi gjer në dhimbje i tëmthave më bëri të mblidhja veten: duhej të kujdesesha për Margën. Duhej t'ia hiqja Margës nga koka idenë e vdekjes. Dhe shfaqja e Hadit në ato rrethana ishte e dëmshme. Tek rruhesha, mendja më vajti te miku im i vjetër, Doktori N.T.

Po ta pranoj thënien sipas së cilës njerëzve të padenjë si unë Fati u bënte ca dhurata të pamerituara, doktori N.T., autoritet mjekësor i njohur, ishte pas Margës dhurata ime tjetër e pamerituar. Kur gëzon miqësinë e një autoriteti të tillë, disa halle jo të vogla familjare, dua të them halle sëmundjesh, zgjidhen

lehtë. Sigurisht, N.T. përfaqësonte për mua shumë më tepër. Në pikëpamje të shëndetit, megjithë abuzimet e mia, unë vetë trokisja rrallë në derën e dhomës së tij të vizitave, në Klinikën e Patologjisë së Përgjithshme, në katin e dhjetë të një godine në spitalin Nr.1 të kryeqytetit. Tek ai unë shkoja për arsye të tjera, kur zemra më lëshonte dhe ekzistenca e humbiste kuptimin. Po të mos përmend se me doktorin N.T. kam dhe një lidhje tjetër. Ai është martuar me Sofikën, dikur vajza më inteligjente në fisin e nënës sime të ndjerë, pra mund ta quaj me plot gojën dhëndër, një dhëndër i gjindshëm dhe i respektueshëm.

Me këtë rast, para se të vazhdoj më tej, e shoh të nevojshme t'i kërkoj mikut tim dhe dhëndrit të respektuar të të gjithë fisit tonë, një ndjesë publike. Këtu e më poshtë emri i tij do të dalë shpesh, në rrethana me të cilat ai nuk ka asnjë lidhje. Është një histori e ngatërruar, por pas kësaj ndjese publike i jap vetes të drejtën t'i shtjelloj gjërat ashtu siç ndodhën, pa patur frikë nga dyshimet që mund të ngrihen rreth gjendjes sime në këtë rrugëtim të rrezikshëm, si ecje mbi tehun e një brisku.

Propozimin për të vajtur të këshilloheshim me doktorin N.T. Marga e quajti të arsyeshëm. Po rrinte e mbështetur pas derës, në hyrje të dhomës, e qetë, dhe një buzëqeshje engjëllore që iu end në fytyrë më ngjalli shpresë. Ajo tha të largoheshim pa u ndjerë, nuk deshi t'i linim Irmës ndonjë shënim për ta njoftuar se ku po shkonim dhe unë mora zemër. Sapo u lehtësova nga e qeshura engjëllore e Margës, trurin ma përshkoi skena erotike me Lorin. Thashë me vete për besë, mund të dalë një skenar i bukur. Po të gjej një producent – problemi i regjisorit zgjidhej – mund të dalë

një film edhe më i bukur. Ky vrundull optimizmi më përfshiu tek zbrisnim shkallët dhe Marga mbahej pas krahut tim. Aroma e parfumit të saj më bëri ta shihja botën të parfumuar dhe, në fund të shkallëve, para se të dilnim jashtë, përveç një regjisori të mundshëm, kisha përcaktuar dy rolet kryesore, aktorin që do të luante burrin rreth të pesëdhjetë e pesave dhe aktoren që do të luante Lorin. Mbetej të ulesha të shkruaja skenarin. Gjithçka varej nga skenari dhe nga ndihma e providencës për të gënjyer natën nëpër gjumë ndonjë producent, mbase pikërisht në çastet kur unë shihja skenarin tim në trajtat e ëndrrës erotike.

Jashtë, nën dritën e diellit, ndodhi shfryrja ime e rrufeshme. Prej shumë vitesh unë nuk mbaja asnjë lidhje me botën e kinemasë, isha përfshirë në listën e parë të kineastëve të nxjerrë në asistencë me rastin e reformës në kinematografi. Varianti që dha për ne një qeveritar i lartë i kohës, ishte i ngjashëm me variantin që iu rekomandua një morie shkrimtarësh të mbetur pa punë nga reforma në institucione të tjera. Për të mbijetuar në kushtet e reja të ekonomisë së tregut, atyre iu sugjerua të shisnin nëpër trotuarët e kryeqytetit paqeta me cigare ose banane. Duke qenë në një pozicion më modest se një shkrimtar –megjithë nja katër libra të botuar nuk e kam mbajtur veten kurrë për shkrimtar – unë nuk e zgjata, zura të merresha nga pak me të gjitha: provova të bëhesha kambist, tregtar i vogël mallrash kinkalerike, furnitor klubesh me pije freskuese, mësues privat frëngjishteje pa liçensë. Në këto kushte, një film i xhiruar sipas një skenari të shkruar prej meje mund të realizohej vetëm nëse unë do ta shihja majën e veshit pa pasqyrë. Megjithatë arsyeja e shfryrjes sime të rrufeshme nuk

ka lidhje me këtë, as me faktin se ideja e një skenari të tillë ishte gomarllëk. Shfryrja ndodhi tek kalonim një rrugëz të shtruar me pllaka betoni, mespërmes sheshit të piedestalit pa shtatore, për të dalë te stacioni i autobusit, dhe befas më kumboi në veshë një përshëndetje e harruar, të cilën nuk e dëgjoja prej vitesh. Dikush, si një mik i vjetër, thirri: "Ah, ja dhe zoti Trapi! Mirëmëngjes, zoti Trapi!"

Ktheva kokën nga Marga. Në majë të gjuhës më erdhi përgjigja nervoze: "Jo, Trapi, zotëri, mbiemri im është Tarapi! Ta-ra-pi!" Nuk fola. Ja sepse fytyra e Margës m'u duk e tejzbehtë, ja sepse, shihej qartë, Marga nuk kishte dëgjuar asgjë. Po të kishte dëgjuar, duke e ditur zemërimin që më përfshinte sa herë ma ngatërronin mbiemrin -qëllimisht ose pa dashje – ajo do të reagonte. Do të rrekej të më mbushte mendjen se ishte marrëzi të nxehesha. Marga nuk reagoi, pra më kishin bërë veshët. Mirëpo sytë më zunë turmën e burrave të ngeshëm të lagjes nën hijen e drurëve, ata që i kisha parë nga dritarja. Tashmë jo në poza të ngurosura. Tashmë, gjithnjë të grumbulluar nëpër stola, burrat luanin të përqëndruar në një heshtje që prishej nga përplasja e gurëve të dominosë, e zarëve të tavllës, nga pëshpërimat e mbytura të shahistëve dhe atyre që luanin me letra. Ca më tej e ca më lart, në shkallët e mermerta të piedestalit, ndodhej ai.

Atë mëngjes të nxehtë shtatori unë nuk mund të bëja ndonjë përqasje të tij me Hadin. Atë mëngjes shtatori më bëri përshtypje vetëm një gjë: kur po kalonim me Margën përmes sheshit, ai nuk po rrinte në këmbë, me njërën dorë të mbështetur te piedestali, me tjetrën të shtrirë në drejtim të Varrezave. Ai po rrinte ulur te shkallët, sipër turmës së burrave, si një

bari vigjilent dhe më shkeli syrin. Kjo u shoqërua me një buzëqeshje aq të lexueshme sa nuk pata më asnjë dyshim, përshëndetjen tallëse ma kishte dërguar ai. Duhet të jetë ndonjë i njohur i vjetër, mendova. Ndonjë nga drejtorët e mi të dikurshëm, shefat e kuadrit apo komandantët e zborit. Ndonjë përgjegjës ndërmarrjeje ose brigadier ferme, ku kryeja muajin e punës fizike. Ndonjë rival i panjohur aventurash dashurore. Së fundi, ndonjë nga regjisorët ose aktorët e filmave të xhiruar me skenarët e mi. E gjithë kjo lukuni njerëzish, qëllimisht ose me dashje – jo rrallë nga idiotësia – i jepnin mbiemrit tim një përmbajtje që shkaktonte të qeshura. Dhe, kuptohet, nervozizmin tim.

Kur i kalova pranë ai më kishte kthyer shpinën. As atë ditë, as më vonë, unë nuk pata mundësi ta shikoja në fytyrë nga afër. Fillova të besoja se ai nuk kishte fytyrë, se fytyra e tij ishte një masë jo lëndore e ardhur nga bota e përtej varrit. Dhe rrinte vigjilonte te shkallët e mermerta të piedestalit pa shtatore. Të thuash se numëronte kokët e tufës, e mbante të mbledhur dhe kur t'i tekej vendoste se cili duhej ndarë. Ai shesh ishte një lloj stacioni. Atje priteshin biletat e rrugës pa kthim për në mbretërinë e Hadit. Më mbetej të përcaktoja nëse mbikqyrësi i stacionit ishte vetë Hadi, ndonjë përfaqësues i tij, apo shtatorja e dikurshme, e rrëzuar nga piedestali dhe e tërhequr zvarrë, kishte marrë edhe një herë rolin e ndërmjetësit midis udhëtarëve që grumbulloheshin atje dhe mbretërisë së Hadit.

Nja tridhjetë hapa më tej nuk e përballova tundimin për të kthyer kokën. Dhe rashë në kurth. Në veshë më mbërritën fjalët: "Kot e ke, zoti Trapi! Kot!"

I futa krahun Margës si të doja ta shtrëngoja pas vetes.

# 3

Në hyrje të spitalit shpresova që dyshimet e Margës të dilnin të kota, siç u ndodh shumicës së njerëzve që alarmohen edhe nga gjëndra më e rëndomtë në trup. Këtë ia thashë tek ngjiteshim me ashensor për në katin e dhjetë të godinës ku, në fund të një korridori, sipër një dere me xham qumështi, me ca shkronja të mëdha qenë shkruar fjalët KLINIKA E PATOLOGJISË SË PËRGJITHSHME dhe, poshtë tyre, me shkronja më të vogla: Dr. Prof. N.T. Marga ose nuk më dëgjoi, ose me heshtjen e saj sikur deshi të më thoshte ta lija të qetë. Përpara dhomës së vizitave të mikut tim po prisnin nja njëzet vetë, ndenjëset rrëzë murit ishin të zëna. U shkëputa nga Marga, iu afrova derës. Trokita lehtë, pastaj më fort, por dera nuk u hap. Nisur nga zbehtësia e Margës, dikush u tregua i sjellshëm, i lëshoi vendin për t'u ulur.

Kaloi mëse një orë derisa Marga u fut. Kjo ndodhi kur N.T. shoqëroi jashtë një paciente, një grua e re, mjaft e bukur, e cila para se t'i vinte radha, tërë kohën kishte shfryrë ndaj infermieres që nuk i hapte rrugë, nuk merrte mundimin së paku të njoftonte doktorin për mbërritjen e saj dhe, nga padurimi, ishte vërtitur poshtë e përpjetë me nervozizëm. Shpërfillja e

infermieres më kishte bërë edhe mua të mos orvatesha t'i kërkoja të njëjtën gjë, domethënë të njoftonte doktorin për mbërritjen time. Kështu që sapo N.T. u shfaq në shoqërinë e gruas së re, përfitova nga rasti t'i sulesha e gati ta zija për jake. Marga vazhdonte të rrinte ulur në ndenjëse dhe ai nxitoi të ndahej nga gruaja e bukur. Askush nuk protestoi për prishjen e radhës. Të gjithë ranë squkë kur i gjithpushtetshmi N.T., po aq shpërfillës sa infermierja e tij, vajti drejt Margës, i futi krahun dhe ata përpara e unë prapa, përmes heshtjes që pllakosi, u gjenda në paradhomë. Marga më hodhi një vështrim të lodhur, m'u lut të qëndroja aty, të mos ndodhesha i pranishëm gjatë kohës që N.T. do të kryente vizitën. U shemba në një karrige. Marga ka vendosur të niset pa mua, mendova kur ata humbën pas derës. Po pse ka vendosur të niset pa mua?

Është shumë e thjeshtë, më shpjegoi doktori. A nuk thuhet se ti je lëkurë qeni? Ajo nuk mund të mbetet e lidhur në amëshim me një lëkurë qeni. Vendi i saj është në parajsë. Ndërsa ti... Oh, fola unë shpejt e shpejt. Unë kam hesape për të larë. Para se të fluturoj drejt ferrit të qiellit, duhet të shlyej ca mëkate këtu, në ferrin e tokës. Ferr për ferr... Si thashë këto, trupi m'u përqeth. Në paradhomë gjendesha vetëm. N.T. ndodhej matanë, po vizitonte Margën. Ai nuk mund të ndodhej njëkohësisht edhe këtu edhe atje. Por unë mund të shpohesha në hundë për të vërtetuar se ato fjalë m'i kishte thënë N.T.

Kur doktori u shfaq në kuadratin e derës isha i pështjelluar. Ai më futi krahun me një gjest tërë përkujdesje, më tërhoqi drejt dhomës së vizitave dhe unë e pashë të arsyeshme të heshtja, të pranoja se më

kishin folur muret. Marga po rrinte ulur në karrige pranë një tryeze të madhe. Margën do ta mbaj disa ditë këtu, tha doktori. Kam një dhomë dyshe ku do të jetë vetëm. Të bëjmë ca analiza, të caktojmë një kurë… Unë për pak desh i ulëriva mikut tim për qetësinë e gënjeshtërt. Sytë e tij të fshehur pas xhamave optikë, rrethuar me një skelet të artë, e kapën menjëherë ç'bluajta. Mos u bëj idiot, më thanë ata sy.

Marga m'i parashtroi dëshirat me një logjikë të ftohtë e në mënyrë të prerë sapo N.T. doli nga dhoma e shtrimit dhe na la vetëm. Fëmijëve nuk duhej t'ua zbuloja të vërtetën e sëmundjes, kjo qe porosia e saj e parë. Dy javë pas shtrimit në spital, e mërzitur nga njerëzit, ajo më kërkoi t'u lutesha të afërmve dhe të njohurve të mos i shkonin më për vizita. Mua më ndaloi të flija qoftë dhe një natë të vetme në shtratin bosh të dhomës – vendosa ta thyeja këtë porosi ca më vonë, kur gjendja e saj u keqësua fare dhe humbiste në kllapi – të thuash se çastin e fundit, kur t'i shfaqej vdekja, kërkonte ta përballonte sy ndër sy. Në heshtje. Siç kishte jetuar. Në një botë të poshtër ku, veç fëmijëve, i ishte dashur të mbikqyrte e të ruante një qenie të dobët: mua.

Tani, pas kthimit nga aventura ime e fundit, besoj që Marga të ndodhet në parajsë. Unë vështirë se do të kem edhe njëherë fatin, kësaj radhe në amëshim, t'i gjendem pranë. Nuk jam i denjë për vendet parajsore. Qielli është për qeniet si Marga. Kështu që po shkëputem nga qielli dhe po vij në tokë, aty ku e lashë pak më sipër, domethënë ditën që Marga u shtrua në spital.

Doktori N.T. më tha se Marga mund ta shtynte e shumta katër muaj. Njoftimi i tij më ra në kokë si

çomage dhe ai më shoqëroi poshtë, në dalje të spitalit. Atje më përqafoi, më tha të mbahesha. Do mbahem, i thashë. Dhe u ndamë. Dhe me t'u ndarë prej tij, pata një ndiesi të çuditshme. Tek ecja në rrugëzat e spitalit për të dalë në stacionin e autobusit, m'u duk sikur dikush po më ndiqte. Përshtypja qe aq e fortë sa nja dy herë ktheva kokën prapa të shihja. S'pashë gjë, askush nuk më ndiqte. Atëherë mendja më vajti te Irma. Më duhej të respektoja porosinë e Margës që fëmijëve të mos u thoja gjë dhe, njëkohësisht, të gjeja një shpjegim bindës për Irmën. Ajo nuk do t'u besonte përrallave, do të alarmohej. Ndërsa detyra ime ishte ta gënjeja, t'i mbushja mendjen të mos bëhej merak, kur e dija mirë se Marga do të vdiste.

Me këmbë të prera ngjita shkallët e pallatit. Tek ngjitesha, përsëri pata atë përshtypjen e çuditshme se dikush më ndiqte, e përsëri ktheva kokën me një lëvizje të shpejtë, si të doja ta zija tjetrin në befasi. Nuk pashë gjë. Një copë herë ia vura veshin heshtjes së shkallëve. Dhe vazhdova të ngjitesha ngadalë derisa mbërrita para derës së apartamentit tim. Nxora çelësin, e futa në bravë, e rrotullova, mbylla derën pas vetes dhe qëndrova në korridor, midis shurdhërisë së apartamentit. Dhoma e Irmës ishte e hapur, krevati i parregulluar, tryeza e saj e punës, mbi të cilën mbante kompjuterin, në një rrëmujë librash e fletoresh, por Irma nuk ndodhej aty. Nuk ndodhej as në dhomën e pritjes, as në kuzhinë, asgjëkundi. Në kuzhinë, mbi tryezën e ngrënies, sytë më zunë një pusullë: "Jam te Lori. Sonte dhe nesër mbrëma do të fle andej. Irma".

E mora pusullën, e grisa dhe zura të kërkoja një vend ku të hidhja copat. Ky veprim, pra grisja

e pusullës dhe zhdukja e saj, qe i kotë. Marga nuk ishte në shtëpi. Irma nuk e dinte ku gjendej Marga. Po ta dinte, me siguri nuk do të linte mesazhe të tilla. Zakonisht, këto lloj mesazhesh Margës i ngrinin nervat. E bënin të vuante. Dhe gjente rastin të shprehte antipatinë e thellë ndaj Lorit. Nuk e shihte dot me sy. Sipas Margës, ajo vajzë me origjinë familjare të dyshimtë, që banonte vetëm, në një apartament po aq të dyshimtë, ushtronte ndikimet më negative ndaj vajzës sonë. Para së gjithash ishte më e madhe në moshë, nja tre apo katër vjet. Irma studente, ajo në marrëdhënie pune. Irma pa përvojë, ajo e rrahur me vaj e me uthull. Irma kalama, ajo sekretare e një fondacioni ku flitej se ishte dashnore e presidentit, burrë i martuar ky, dhe skandali kishte mbërritur në faqet e gazetave. Para se të njihej me të, Irma nuk frekuentonte as diskotekat, as klubet, as shoqëritë e zhurmshme, nuk e kishte zakon të linte mesazhe të tilla e herë pas here të mungonte në shtëpi fundjavave, dhe Lori shërbente gjithmonë si mbulesë. Por Marga nuk ndodhej në shtëpi dhe mua nuk më duhej të përpiqesha ta qetësoja, t'i mbushja mendjen se këtu nuk kishte asgjë të keqe. Në këto raste, kur më shumë doja të qetësoja Margën se sa të mbroja Irmën, ajo më shkrehej mua. Më bënte fajtor. Sipas saj, me qëndrimet e buta, unë po e prishja vajzën.

M'u tha fyti. Vajta mora në frigorifer një birrë. Mbase ajo ka të drejtë, mendova. Mbase duhej të isha sjellë ndryshe me Irmën. Dhe më hipi një vrundull zemërimi. Jo ndaj Irmës. Irma nuk e dinte se Marga ishte shtruar në spital. Ajo vazhdonte jetën normale me gënjeshtrat e zakonshme. Marga nuk i gëlltiste gënjeshtrat e saj, unë i gëlltisja. Tek Irma shihja riprodhimin e vetes në

trajta femërore. Kur Marga e qortonte aq sa e bënte për të qarë, mua më vinte keq. Thosha me vete se Irma mund të quhej një vajzë vërtet e përmbajtur në sjellje krahasuar me qenien femërore të mundshme nëse në barkun e nënës sime unë do të isha ngjizur jo në trajta mashkullore por femër. Do të kisha qenë një femër e poshtër, sipas konceptit të Margës. Një koleksionuese meshkujsh.

Po më zihej fryma, shpirtin po ma brente një dyshim. Largimin e parakohshëm të Margës nga kjo botë e kisha përgatitur unë. Çdo vit, çdo muaj, çdo javë. Marga ngutej të largohej pa mua. Nuk donte të më kishte pranë. Nuk më lejoi së paku t'i kaloja netët në krevatin bosh të dhomës së shtrimit. Ky arsyetim më zhyti në një krizë fajësie. Dhe u përfshiva nga paniku. Dhe zura të dyshoja se në dhomë nuk isha vetëm. Zura të dyshoja se ai që më kishte ndjekur nga prapa gjatë rrugës së kthimit për në shtëpi, kishte mundur të futej brenda tinëzisht në çastin e hapjes së derës. Tani, i fshehur pas mureve, më përgjonte. Ishte i aftë të futej brenda meje. Me ajrin që thithja, nëpërmjet poreve të lëkurës, në formë valësh elektromagnetike që kontrollonin qelizat e trurit tim. Mbi të gjitha, i ndieja frymëmarrjen.

E di, fola pas një ngurrimi të gjatë. Dhe u drodha. Dhe rashë në gjunjë. Zëri im m'u duk i huaj. Mund të mos kem folur fare. Mund të ketë qenë jehona e mbytur e pavetëdijës. Këtë mendova kur e zura veten në gjunjë. Ishte një veprim qesharak. Në rastin më të mirë, refleks leximesh. Megjithatë nuk desha ta pranoja këtë variant. Isha i prirur të besoja në gjëra të forta. Të besoja, fjala vjen, se pas mureve të dhomës ndoshta

rrinte e më përgjonte njëri nga të mëdhenjtë: Buda, Jezu Krishti apo Muhameti, qoftë dhe ndonjë profet tjetër. Një gjasë të tillë e hodha poshtë, ishte një pretendim tepër i lartë nga ana ime. Po aq e dyshimtë m'u duk gjasa që pas mureve të më përgjonte Djalli. Ky nuk hynte fare, unë nuk isha doktor Faust. Një copë herë, pra, ngurrova i trembur nga vetja, nga zëri im, gjithnjë e më i bindur se dikush më përgjonte e nëse ky nuk mund të ishte asnjëri nga profetët e mëdhenj, as djalli, as ndonjë fantazmë e ndritur mbretërore, sidoqoftë duhej të ishte një fantazmë, sado mediokre, e denjë për qenie si unë.

E di, mora zemër, ti po më dëgjon. S'ka rëndësi kush je. As dua ta mësoj. Tani mbi kalendar njëshit të pasuar nga tri nënta, së shpejti do t'i zërë vendin dyshi i pasuar nga tri zero. Duhet të jetë i llahtarshëm çasti i përmbysjes së katër shifrave dhe zëvendësimi i tyre i rrufeshëm me katër shifra të tjera. Ose i mrekullishëm. Në këtë prag unë nuk përjetoj ndonjë mrekulli. Në këtë prag po më përpin një hon i errët, goja e hapur që gëlltit lumin e kohës. Lundroj i rrëmbyer nga vorbullat e tij për t'u zhdukur, pa e ditur ç'më pret: në çastin e kryqëzimit të mijëvjeçarëve do të mbetem në hullinë e të vjetrit apo hullia e re do të më marrë dhe mua. Pa Margën. Dhe me këto përpëlitje të shpirtit...

Në këtë pikë filli i arsyetimit m'u ngatërrua. Në kokë më mbeti fjala shpirt si një kokrrizë rëre që më gërricte cipën e trurit. Dhe më futi në një hulli krejt tjetër. Si një tren i zhvendosur nga shinat.

Përmenda fjalën shpirt, thashë i nervozuar. Më tremb kjo fjalë. Nuk di si ta marr. Shpesh jam akuzuar,

jam quajtur njeri pa shpirt. Në epokën kinematografike të jetës sime këtë ma thoshin të gjithë. Jo njerëzit. As kolegët. As kritikët zyrtarë. Këta të fundit, në të shumtën e rasteve, i ngrinin në qiell filmat e xhiruar sipas skenarëve të mi. Lëvdatat, siç është e natyrshme, u shkonin regjisorëve. Në këtë pikëpamje kam qenë me fat, skenarët e mi kapeshin gjithmonë nga regjisorë të shkathët. Por megjithëse humbisja i eklipsuar nga regjisorët dhe vedetat e kinemasë, unë nuk mërzitesha. Arsyeja lidhet me fjalën shpirt: gjendesha i kapërthyer në një luftë të përhershme me personazhet e mi. Personazhet e mi kërkonin kokën time. Qysh kur nisja t'i skicoja, ata më hanin shpirtin. Sipas tyre mua më mungonte fantazia, ato që shkruaja ishin gjëra të shpëlara, të shpifura, gjëra pa shpirt. U jepja të drejtë. Skenarët e mi, pavarësisht lëvdatave që merrnin regjisorët, nuk vlenin, e dija. Mirëpo dija edhe tjetrën: skenarët kështu kishin mundësinë më të madhe për t'u kthyer në filma, unë të përligjia ekzistencën time e kjo do të thoshte të firmosja dy herë në muaj borderonë e rrogës simbolike me të cilën shpërblehesha. Në këtë mes shpirti nuk hynte fare. Mua më kërkohej të krijoja imazhe ku njerëzit të shihnin lumturinë e tyre. Të kënaqeshin duke parë lumturinë e tyre. Të besonin se e vërteta ishte ky imazh kinematografik i lumturisë e jeta t'u dukej si një film ku ata, protagonistë butaforikë, krekoseshin të vetëkënaqur. Isha i zhytur deri në grykë në atë maskaradë. I përndjekur nga personazhet e mi. Ata më shfaqeshin nëpër gjumë, më akuzonin si mistifikator. Akuzat e tyre më bënin të vuaja. Ishin ca krijesa të mjera, impotente dhe mua më vinte keq. E kuptoja se sa padrejtësisht sillesha ndaj tyre. Keqardhja ime i

ngjante asaj të një prindi për një fëmijë të lindur me të meta, fizike apo mendore, me ndryshimin se nuk ka prind në botë që të sjellë në jetë qëllimisht një krijesë të tillë ndërsa unë i gjymtoja personazhet me vetëdijë, në të kundërt ata do të bëheshin të rrezikshëm. Do të ngrinin krye, do t'i shpërthenin skemat e skenarëve të mi e kjo do të sillte një përmbysje të roleve: unë nga zot do të kthehesha në rob të tyre. Ideja se mund të kthehesha në rob të personazheve të mi më tmerronte. Sa më shumë përpiqeshin ata t'i shpërthenin kornizat, aq më shumë i shtrëngoja unë, i mbaja të lidhur, si despot. Kisha dy fëmijë për të ushqyer, personazhet e mi duhej të tregoheshin tolerantë. Në përplasjet tona netëve pa gjumë u lutesha të më linin të qetë, të mos binin pre e iluzionit bosh me emërtimin edhe më bosh të të ashtuquajturit guxim krijues. Ky ishte një kurth ku ziheshin e binin kohë më kohë ca naivë, por ti, qenie e fshehur, nuk mund t'i kuptosh këto. Nëse unë do ta haja atë kokërr ulliri, personazhet e mi do të hanin kokën time. Ishte, si të thuash, një luftë për ekzistencë.

Ta themi midis nesh: unë nuk jam shquar fort për zgjuarsi. Atë kokërr ulliri nuk e hëngra jo falë ndonjë zgjuarsie. Iu shmanga sepse naivitetin, këtë cilësi me hire fisnikërore, e kam humbur shpejt. Qysh kur fillova të njihja botën dhe ajo më tregoi fytyrën e saj të shëmtuar. Janë fatlumë ata që në fëmijëri bota u shfaqet me fytyrë të bukur. Nën ndikimin e fytyrës së bukur të botës shqisat stërhollohen, ndjenjat përkoren, njeriu fiton klas. Në një periudhë të fëmijërisë edhe mua bota m'u shfaq me fytyrë të bukur, kam qenë dhe naiv. Gjurmë të atij naiviteti i ruaj edhe sot. Ndonjëherë më shkojnë ndërmend lloj-lloj përrallash. Them me vete ah, sikur të jetë e

mundur të përjetoj një skenar tjetër, jo atë që më çoi në moshë ende të njomë drejt fytyrës së shëmtuar të botës. Mirëpo sado të përpiqem t'i largohem skenarit të vjetër, e kam të pamundur. Banaliteti më zë për fyti. Më dëgjon?

Askush nuk m'u përgjigj. Vazhdova të rrija në gjunjë dhe balli m'u mbush me djersë.

Më dëgjon? - këmbëngula. - Më dëgjon?

Nuk më dëgjonte njeri. Qenia e fshehur ishte zhdukur. Kisha mbetur vetëm, në zanafillë të botës.

# 4

Në zanafillë, fytyra e parë e bukur e botës m'u shfaq në trajtat e nënës. Nëna ime ishte një grua shumë e bukur, punonte në një shkollë foshnjore, siç quheshin aso kohe kopshtet e fëmijëve. Ajo më merrte me vete çdo mëngjes, më mbante në grupin e saj dhe pasdite, kur ktheheshim në shtëpi, unë i ankohesha gjithmonë, ajo përkëdhelte vetëm fëmijët e tjerë, sidomos një djalë nga mëhalla ku banonim, të cilit i thoshte se e donte shumë. Mbi përparësen e tij të bardhë ishin qendisur dy shkronja, të vetmet që mësova t'i njihja para se të futesha në shkollë: N.T. Unë i ankohesha nënës plot dëshpërim se ajo donte më shumë djalin me shkronjat N.T. sesa mua. Nëna qeshte, më siguronte se unë isha i dashuri i saj i vetëm dhe, duke më fërkuar kokën, më kërkonte të mos bëhesha xheloz. Ajo zjarrmi, ajo pakënaqësi që as e merrja mundimin ta fshihja kur ndeshnim rastësisht në rrugë ose gjatë shëtitjeve ndonjë të njohur, mund të kishte vetëm një emër: xhelozi. Kjo vazhdoi të më mundonte derisa u fshi nga disa episode të tjera, kur zuri të më shfaqej ana e pasme e medaljes, fytyra e shëmtuar e botës.

Atëherë ne banonim si qiraxhinj në katin e dytë të një shëpie private prej qerpiçi, në një lagje shumë afër qendrës së Tiranës. Përballë, nja tridhjetë metra më tutje, ngrihej një ndërtesë e lartë, me një lulishte ku qenë mbjellë drurë pishe dhe rrepe. Në mes të lulishtes kishte një pistë vallëzimi dhe, pranë pistës, një vend me strehë për orkestrën. Ndërtesa quhej Shtëpia e Oficerëve.

Në dimër, sidomos ditëve të ftohta ose me mot të keq, lulishtja ishte e shkretë. Njerëzit, më së shumti ushtarakë, mbylleshin në sallat e brendshme të godinës. Por në mot të kthjellët e në verë, lulishtja gumëzhinte.

I kam para syve ato mbrëmje të largëta verore, plot hare. Bashkë me nënën, ulur pranë një dritareje të sallonit, rrinim ndonjëherë me orë duke soditur festat e përnatshme në lulishten përballë. Im atë, violinist, qëllonte të kthehej vonë sepse mbrëmjeve luante në orkestrën e Filarmonisë së qytetit. Dhe sa të kthehej ai, ne ndiqnim një shfaqje tjetër, atë të lulishtes, si të ndodheshim në një lozhë teatri. Prej andej shihnim kamerierët me papijon të zi, grumbujt e oficerëve mbledhur kokë më kokë rreth tryezave, çiftet që, me të nisur orkestra dhe zëri i një këngëtari me mikrofon në dorë përhapej e dëgjohej në shtëpitë e mëhallës, ngriheshin, mbushnin pistën dhe kërcenin tango ose fokstrot. Kjo vazhdonte derisa në rrugë, nën dritën e llampës elektrike të një shtylle, dalloja tim atë, me këllëfin e violinës nën sqetull. Atëherë unë e braktisja shfaqjen e lulishtes. Nëpërmjet një palë shkallësh të drunjta, zbrisja në sallonin e katit përdhes. Prej andej, përmes një dere të vogël, të cilën natën e mbyllnim nga brenda me reze, dilja në oborrin e shtëpisë. Në cepin

e majtë të oborrit ishte një pus i vjetër pa ujë, këndej pusit një kajsi. Në cepin e djathtë, muri rrethues përfundonte me derën e oborrit që natën, përveçse me një reze të madhe, e mbyllnim me një çelës të rëndë e të nxirë. Vrapoja nëpër oborr me një frymë, ngrija rezen e madhe, dilja jashtë dhe ndërkaq gjendesha përballë babait.

Im atë ka vdekur i ri. Kur vdiq im atë unë vazhdoja klasën e pestë ndërsa motra nuk duhej të ishte më e madhe se katër-pesë vjeç. Ai vdiq në sanatorium nga tuberkulozi. Mbaj mend se, për disa kohë, duke filluar nga dita kur ai u mbyll në sanatorium, unë dhe motra iu nënshtruam një kure në shtëpi me disa lloj hapjesh dhe mua tërë kohën më vinte për të vjellë. Shumë vjet pas vdekjes së babait, kur takoja rastësisht miq të tij të dikurshëm, ata më thoshin se cilësia më e çmuar e tim eti ishte një mirësi e shkujdesur. Nuk e kundërshtoja këtë thënie. Nuk e kundërshtoj as tani.

Ai përkulej dhe ndërsa me njërin krah shtrëngonte nën sqetull violinën, me krahun tjetër më ngrinte përpjetë. Kjo ndodhte kur im atë kishte hedhur ndonjë gotë. Unë ndjeja aromën e trupit të tij përzier me erën e duhanit dhe alkoolit. Por ndodhte që ai të mos përkulej për të më marrë në krahë, çka më linte të kuptoja se nuk kishte pirë, mbyllte derën me reze, rrotullonte në bravë çelësin e rëndë, e varte në një gozhdë të ngulur mbi mur posaçërisht për këtë punë dhe, duke ecur me kujdes për të mos bërë zhurmë, kalonim oborrin. Futeshim në derën e brendshme të shtëpisë, e mbyllnim nga brenda me reze dhe, gjithmonë tërë kujdes për të mos bërë zhurmë, ngjitnim shkallët e drunjta, që të çonin në sallonin midis dy dhomave tona në katin e sipërm.

Në mes të sallonit ndodhej tryeza e ngrënies. Zakonisht ne uleshim atje të tre në vaktin e darkës. Prindërit zinin vend përballë njëri-tjetrit ndërsa unë në mes. Ata hanin në heshtje, më të rrallë këmbenin ndonjë fjalë. Tek hanim ndiqja herë lëvizjet e duarve të babait me thikën e pirunin, herë ato të nënës, që gjithmonë më tërhiqte vërejtjen se nuk duhej të mbllaçitesha me zhurmë kur përtypja ushqimin. Si mbaronim së ngrëni dhe nëna ngrinte tryezën, ata të dy luanin me letra. Ky zakon i luajtjes me letra vazhdoi derisa unë u bëra me një motër. Prindërit e quajtën Brunilda. Qyshse lindi ajo, prindërit pothuaj nuk luanin më me letra pas darke dhe merreshin vetëm me të. Nëna dukej aq e përpirë sa edhe në rastet kur unë qëllimisht përplasja pirunin ose lugën te pjata dhe mbllaçitesha me zhurmë, ajo nuk vinte re asgjë. Kjo periudhë e fëmijërisë ka dy kohë: para ardhjes së Brunildës dhe pas ardhjes së saj.

Në fillim, koha para ardhjes së Brunildës. Në dhomat e katit poshtë nesh, me të cilin na ndante një dysheme prej dërrase, banonte një familje e madhe. Mbaj mend disa djem më të rritur se unë, një grua të re me syze, autoritare, motra e djemve, që rrinte shpesh duke lexuar ulur mbi një karrige nën drurin e kajsisë, një plakë, përkëdheljet e gruas me syze kur qëllonte të ndodhesha pranë saj. Mbaj mend gjithashtu se gruaja e re autoritare me syze, sipas bisedave të prindërve, kishte rënë nga pozita e me këtë shpjegohej që ata banonin poshtë nesh, në një shtëpi ndërtuar me tulla qerpiçi dhe mbuluar nga një çati me tjegulla, pullazet e së cilës ishin plot fole laraskash. Atëherë unë nuk kisha ndonjë ide se çdo të thoshte të ishe person i rënë nga

pozita. Marrëdhëniet e prindërve të mi me ta ishin formale, po të mos përmend se njëri nga djemtë një herë më dha një flakurimë turinjve sepse, pa dashur, tek luaja në oborr me një top llastiku, unë e godita topin fort dhe ai shkoi e theu xhamin e dritares së një dhome. Ndodhi vetëm që gruaja me syze qortoi djalin, i tha se duhej t'i vinte turp që merrej me një fëmijë, ndërsa unë u ndëshkova nga prindërit që të mos e prekja për një javë të tërë topin prej llastiku. Pastaj erdhi një ditë dhe kati i poshtëm u boshatis. Bujtësit u larguan, largimin e tyre e ndoqi një turmë e madhe kureshtarësh, banorë të mëhallës. Në një farë largësie ata shoqëruan ngarkimin e plaçkave të tyre mbi një kamion dhe nuk kaloi shumë kur portretin e gruas me syze zura ta shihja në vargun e portreteve të mëdha që vareshin në faqet e ndërtesave qeveritare në raste festash: ishte ringritur në pozitë. Disa vjet më vonë, për ironi të fatit, ajo u zhduk përsëri nga vargu i portreteve zyrtare, poshtë e përpjetë në mëhallë thuhej se qorrja, domethënë gruaja me syze, u rrëzua nga fiku për të dytën herë, kësaj radhe përfundimisht, u shpall armike, dhe unë tashmë isha në një moshë kur e kuptoja ç'do të thoshte kjo. Por kur ajo bashkë me familjen u largua nga kati i poshtëm i shtëpisë sonë, u ngrit në pozitë, unë nuk e dija ç'kuptim konkret kishte të ngriheshe në pozitë apo e kundërta, ç'kuptim figurativ kishte të bije nga fiku e të thyeje qafën. Në katin poshtë nesh, mesa dukej, fshihej një mallkim. Të gjithë ata që strehoheshin atje i ndiqte fatkeqësia. Megjithatë, ai nuk mbeti bosh gjatë. Largimi i gruas me syze u pasua me mbërritjen e një personi të veçantë. Po e quaj thjesht Profesor, siç e thërriste im atë. Kjo

përkon me kohën kur vura re se barku i nënës po fryhej e ajo më tha se së shpejti do të bëhesha me një motër ose me një vëlla. Unë nuk e dija se edhe personi në fjalë ishte i kategorisë së të rënëve nga fiku.

Profesori mbërriti një ditë të ftohtë dimri me shi. Atë e solli një xhips, pas xhipsit vinte një kamion i mbuluar, mbushur me plaçka. Te dera e madhe e priste i zoti i shtëpisë. Nga dritarja e sallonit ku po rrija, unë e pashë të zotin e shtëpisë që hyri në oborr dhe disa hamej, megjithëse vazhdonte të binte shi, filluan të shkarkonin sendet e t'i fusnin nëpër dhoma. U hap dhe dera e xhipsit. Në fillim prej andej zbriti dikush me çadër në dorë. Pas tij një plakë, e cila u fut menjëherë nën çadër. Burri ishte Profesori, plaka e ëma. Kjo qe një grua trupvogël, pak e kërrusur, veshur me çitiane, rreth kokës mbante një shall të zi dhe pa e zgjatur u fut brenda. Tjetri, me çadër në dorë, qëndroi në mes të oborrit.Hamejtë i dhanë fund sistemimit të plaçkave, i zoti i shtëpisë u përshëndet me të sapoardhurin dhe u largua. Ky vazhdoi të qëndronte një copë herë në mes të oborrit. Pastaj ngriti kokën dhe vështroi nga dritarja ku po rrija unë. Për një çast sytë tanë u kryqëzuan. Ndryshe nga e ëma, ai ishte shtatlartë. Mbeta si i hipnotizuar nga vështrimi i syve të tij. Kishte një fytyrë të zbehtë dhe mendimi i parë që më shkrepëtiu në tru ishte të tërhiqesha nga dritarja që ai të mos mendonte së unë tërë kohën kisha qëndruar duke ndjekur fshehurazi veprimet e tij. Por para se ta bëja këtë, ai më buzëqeshi. Dhe më dha një përshëndetje ushtarakisht. Megjithatë unë u largova nga dritarja.Atëherë duhet të kem qenë jo më shumë se pesë vjeç.

Mbërritja e Profesorit dhe vendosja e tij poshtë nesh parapriu ardhjen e Brunildës. Ajo lindi pak muaj më vonë, në maj. Edhe kësaj radhe unë po rrija në dritaren e sallonit kur vura re një pajton që tërhiqej nga një kalë i bardhë. Pajtoni ndaloi pranë shtëpisë, prej tij në fillim zbriti babai, pastaj nëna, ngadalë, tërë kujdes, me diçka midis duarve, mbështjellë me batanije: ishte Brunilda. Ata shtynë derën e jashtëme, kaluan nëpër oborr, zunë të ngjitnin shkallët e drunjta dhe kur u shfaqën në sallon, pa lëvizur nga vendi, prita që nëna të vinte drejt meje. Ajo erdhi drejt meje, por as më puthi, as më përkëdheli. Vetëm sa u përkul pak, zbuloi batanijen dhe unë pashë fytyrën e një qenieje të përgjumur, gati pa flokë. Desha të thosha se koka e saj ishte e shëmtuar, si kokë miu, ndoshta për të shprehur pakënaqësinë që nëna as më puthi, as më përkëdheli. Pa e vënë re pakënaqësinë time, prindërit, bashkë me qenien e përgjumur, u mbyllën në dhomë. Unë mbeta atje ku isha. Më pushtoi një dëshirë inatçore të bëja ndonjë marrëzi, të kryeja veprime të ndaluara, fjala vjen të merrja topin e llastikut e të luaja në sallon apo të zbrisja poshtë, t'i ngjitesha kajsisë deri në majë. Kjo dëshirë për të kryer marrëzira nuk m'u shqit gjatë gjithë asaj dite. Nuk m'u shqit gjatë gjithë javës, gjatë gjithë verës. Më vinte të ulërija, më vinte për të qarë: mua nuk ma varnin më. Prindërit, të afërmit, fqinjët, të gjithë flisnin vetëm për Brunildën. E të mendosh se e mjera Brunildë nuk jetoi gjatë. Ajo vdiq nja dy vjet pas babait, në kohën e një epidemie të rëndë gripi. Varret e tyre janë pranë njëri-tjetrit dhe dikur nëna më merrte me vete çdo të diel e të dy bashkë shkonim t'u ndiznim qirinj. Siç thuhet, Zoti më ndjeftë për xhelozinë time prej çapaçuli. Vuajtja e asaj xhelozie vazhdoi deri

në shtator, kur nisa klasën e parë. Atëherë vjen dhe personazhi i fundit që mbyll epokën e fëmijërisë së hershme. E quanin Liza. Ishte mësuesja ime. Fytyra e dytë e bukur me të cilën m'u shfaq bota.

Ato kohë, kur Profesori u vendos në katin poshtë nesh, im atë kthehej në shtëpi gjithnjë e më shpesh i pirë. Ky është një kapitull që mua më mbush me dhimbje dhe nuk dua të zgjatem. Në raste të tilla nëna më urdhëronte të shkoja në dhomën time, ku më brente kureshtja për të marrë vesh ç'do të ndodhte. Por ata nuk qëndronin në sallon, mbylleshin në dhomën e tyre dhe unë nuk dëgjoja gjë. Përkundrazi, me pak vëmendje isha në gjendje të dëgjoja zhurmat që vinin nga një drejtim tjetër. Në dhomën poshtë meje flinte Profesori, na ndante vetëm një dysheme e hollë prej dërrasash. Kjo ishte arsyeja që në shtëpinë tonë kurdoherë flitej me zë të ulët, ecej me kujdes, sikur të shkelnim mbi vezë dhe me mbërritjen e tij porosia e prindërve për mua qe kategorike: nuk duhej të shkaktoja as zhurmën më të vogël.

Bujtësit e rinj u ngjitën te ne për herë të parë një mbrëmje, disa ditë pas mbërritjes së tyre. Babai sapo ishte kthyer në shtëpi. Nuk mund të them në kishte pirë apo jo, mund të them vetëm se sjelljet e tij atë mbrëmje ishin disi të çuditshme. Ai dukej në qejf, bënte shaka me nënën, ndonëse kësaj nuk i vinte dhe aq për të qeshur. Sidoqoftë, ajo nuk më urdhëroi të largohesha, të shkoja të mbyllesha në dhomën time. Diçka të tillë ma kërkoi pak më vonë, kur nëpër shkallë u ndjenë hapa dhe u kuptua se atë mbrëmje do të kishim vizitorë.

Në fillim, në krye të shkallëve u shfaq plaka trupvogël me çitiane. Pas saj, duke ecur me kujdes, të

thuash se kishte frikë mos përplaste kokën gjëkundi në hapësirën e ngushtë të shkallëve, u duk Profesori. Prindërit e mi mbetën në këmbë të hutuar. Im atë u ngut t'i ftonte të sapoardhurit tërë mirësjellje, me një përpjekje për ta mbajtur plakën përkrahu. Kjo nuk pati nevojë ta mbanin dhe vajti zuri vend atje ku i priu im atë, te një kanape në krye të sallonit. Nëna, edhe pasi miqtë u rehatuan dhe babai u ul në një karrige pranë tyre, vazhdoi të rrinte më këmbë, e hutuar. E vetmja gjë që i ra ndërmend, ndoshta për focë zakoni, ishte të më urdhëronte të shkoja në dhomën time. Për fat, me ërdhi në ndihmë Profesori. Ky shfaqi dëshirën që unë të rrija dhe sapo im atë miratoi, pa pritur që ai ta përsëriste dy herë, vajta u ula në kanape, midis Profesorit dhe plakës me çitiane.

Mua më lejohej shumë rrallë të ndodhesha i pranishëm në bisedat e të rriturve. Edhe në rastet kur lejohesha, më pas nëna do të më qortonte për zakonin tim të keq: flisja vend e pa vend, kërkoja të bëhesha interesant dhe i bezdisja të tjerët me llafazanëritë e mia. Kështu që, me të zënë vend midis Profesorit dhe plakës, duke dashur ta siguroja nënën se do të sillesha denjësisht, e kyça gojën. Dhe, me një ndjenjë fajësie për mosbindjen time, tërë kohën i mbaja sytë tek ajo. Mirëpo ajo as që e kishte mendjen tek unë. Ajo vazhdonte të ishte e hutuar dhe, ndryshe nga im atë, gati nuk mori pjesë fare në bisedë. Qeshi vetëm një herë, kur qeshën të gjithë. Profesori po tregonte një ndodhi për një mision ushtarak anglez të hedhur me parashutë gjatë luftës. Profesori kishte shërbyer pranë misionit si përkthyes dhe tha se me të zbritur nga qielli, kërkesa e parë e anglezëve kishte qenë ndërtimi i një WC-je fushore.Plaka me çitiane vërejti

se më e saktë do të ishte të quheshin hale fushore. Atëherë qeshën të gjithë, qeshi dhe nëna.

Të nesërmen në mëngjes, me të hapur sytë, ajo më kërkoi diçka të çuditshme: vizitën e Profesorit te ne nuk duhej t'ia tregoja njeriu. Po rrinte në sallon, sikur tërë natën kishte pritur aty me padurim sa të zgjohesha unë. Pata frikë se ndoshta do të më qortonte për mosbindjen e mbrëmshme dhe nuk e kapa menjëherë domethënien e kërkesës së saj. Një natë më parë, pa kuptuar ndonjë gjë të madhe nga bisedat e të rriturve, kisha arritur të krijoja një mendim për Profesorin: ai duhej të ishte një njeri jo i zakonshëm. Këtë e dëshmonin sjelljet e prindërve. Ndërsa nëna tërë kohën qëndroi si mbi gjemba, im atë ishte i ndezur. Kjo kulmoi me një veprim të rrallë të tij: ai luajti me violinë. Unë nuk e kisha parë asnjëherë tim atë të luante me violinë para ndonjë mysafiri. Kur nëna, me të hapur sytë, më drejtoi atë kërkesën e çuditshme, mua vazhdonin të më kumbonin në veshë tingujt e magjishëm të violinës së babait. Me këta tinguj më kishte zënë gjumi. Mbaja mend copëra bisedash për Torinon, ku kishte studiuar im atë, për Moskën, ku Profesori kishte kaluar disa vjet para lufte, plakën me çitiane, së cilës kohë më kohë i hapej goja dhe nënën, të zbehtë e të heshtur. Pastaj një hapësirë të kaltër me re të bardha, një ujëvarë plot ylberë, një dorë të butë mbi kokën time. E së fundi asgjë.

Nuk e di nëse për porosinë e çuditshme nëna ishte këshilluar me tim atë. Jam i bindur se nuk duhej të ishte këshilluar. Megjithatë, porosinë e zbatova. As atë ditë, as më vonë, unë nuk u fola shokëve të mi për vizitën. Në fillim sepse këtë ma kishte kërkuar nëna dhe nga zëri, nga sytë e saj, që më vështruan si me

frikë, ndjeva se duhej të bëja siç më thoshte. Më pas nga djemtë e lagjes mësova se fqinji ynë i katit përdhes ishte një person i rrezikshëm, një spiun i Titos. Këto mjaftonin t'ia ngjethnin mishin qoftë dhe një fëmije. Kështu nisi për mua një ekzistencë e dyfishtë. Një jetë midis frikës dhe kureshtjes, ku më e fortë doli kureshtja.

Pareti i hollë që ndante dhomën ku flija unë me dhomën e Profesorit më lejonte të merrja vesh çdo lëvizje të tij: të kuptoja nëse ishte në shtëpi apo jo, kur hynte e kur dilte, në i vinin njerëz për vizitë apo nuk i vinin. Përmes një vrime në dërrasën e dyshemesë isha në gjendje të shihja pak a shumë çdo send në dhomën poshtë. Vrima binte mbi një skrivani, vazhdimisht e ngarkuar me libra, letra të bardha e lapsa.Pak më tej, mbi një fron, gjendej një makinë daktilografike. Në anë të skrivanisë ishte një shtrat hekuri ku flinte profesori ndërsa përballë, pranë derës, një dollap rrobash. Në një farë mënyre zura ta spiunoja Profesorin. Me syrin e sotëm mund të them se ai bënte një jetë të vetmuar. Pa dyshim, ajo duhej të ishte dhe shumë e trishtuar.

Gjatë ditës ai rrinte mbyllur, tërë kohën ulur para skrivanisë.As i hynte, as i dilte njeri, po të mos përmend plakën me çitiane. Në një orë të caktuar ajo futej në dhomë me një tabaka, ku kishte dy filxhana me kafe dhe ulej në të vetmin kolltuk që gjendej atje. Qëndronte në dhomë derisa mbaronin kafet, në një heshtje të thellë, zhytur secili në mendimet e veta. Më në fund plaka ngrihej, vendoste mbi tabaka filxhanët dhe largohej nga dhoma pa u ndier. Atëherë Profesori i kthehej punës.Lexonte shumë, ndonjëherë edhe

shkruante. Ndërsa pasditeve dilte. E kam para syve si tani me një raketë tenisi krahaqafë, veshur me kostum sportiv, pantallona të shkurtëra e bluzë të bardhë, një kapele po të bardhë, strehëgjërë. Dhe ia hipte një biçiklete "Bianki", që e mbante në oborr. Sipas shokëve të mi, ai shkonte të luante tenis herë në Parkun e Xha Tonit, herë s'dihej se ku. Parku i Xha Tonit ndodhej në rrugën e Kavajës, atje ku sot ngrihet një palestër lojërash me dorë.

Seancat më interesante të përgjimit tim ishin mbrëmjeve. Atëherë shihja dhe të vetmin njeri që e vizitonte, përveç plakës me çitiane. Ky qe një burrë i shkurtër, i thatë. Kur vinte ai, Profesori i lëshonte karriken e vet. I vendoste përpara makinën daktilografike dhe duke u sorollatur nëpër dhomë diktonte me zë të lartë, me një libër ose fletë dorëshkrimesh në dorë. Më pëlqente sidomos pamja e burrit të shkurtër kur Profesori heshtëte për një çast, i ndërpriste ecejaket, mendohej dhe tjetri rrinte si një brumbull i hutuar. Gjithçka kridhej në një qetësi të shurdhër dhe sapo Profesori rifillonte diktimin, rifillonin dhe goditjet e makinës daktilografike. Brumbulli i kthehej tastierës, në breshëritë që vinin nga poshtë merrnin pjesë të dhjetë gishtat e duarve të tij. Sipër goditjeve ngrihej zëri i Profesorit dhe në veshët e mi mbërrinte një zhurmë e mbytur, monotone gjer në trullosje dhe ndodhte të më zinte gjumi atje, mbi dysheme.

Profesori erdhi për herë të fundit te ne mbrëmjen e ditës kur babai solli në shtëpi nënën dhe Brunildën me pajtonin që tërhiqej nga një kalë i bardhë. Mundet të ketë ardhur edhe herë të tjera por, ose unë nuk kam qenë i pranishëm, ose më janë fshirë nga kujtesa.

Nëna iu soll ftohtë. Qëndroi fare pak në sallon, vetëm sa u shërbeu kafet dhe u tërhoq në dhomën e saj duke nxjerrë si shkak fëmijën. Edhe babai, megjithëse përpiqej të tregohej i përzemërt, nuk e fshihte dot turbullimin. Kësaj radhe ai nuk i ra violinës, biseda e tyre nuk zgjati shumë. Nuk u fol më as për Torinon, as për Moskën, as për WC-të fushore të ushtarakëve anglezë dhe Profesori duhet ta ketë kuptuar se nuk ishte më dhe aq i mirëpritur: fqinjët e tij duhet të kishin frikë. Pa dyshim, kështu ka menduar, përderisa edhe unë kështu mendova. Prindërit e mi kishin frikë. Ai ishte një person i rrezikshëm dhe spiun i Titos.

Ndryshe nga prindërit, Profesori mua nuk më ngjallte frikë. Ka qenë koha kur pas lindjes së Brunildës zura të ndihesha i braktisur e mbase për këtë arsye më vinte keq për Profesorin. Kisha vetëm një dëshirë: t'u shmangesha prindërve. Pa mbushur ende gjashtë vjeç, në kokë më lindi ideja e arratisë, e largimit nga shtëpia. Varianti që përpunoja ishte ky: dilja në rrugë, i qepesha ndonjë fshatari, i thosha se isha një fëmijë jetim dhe i lutesha të më merrte me vete. Një ditë vërtet iu qepa dikujt. Ky kishte një gomar, i vajta prapa një copë rruge dhe kur u bëra gati t'i zbrazja gënjeshtrën time pata frikë. Po sikur ai të më çonte në rajonin e policisë? Jo, ideja e arratisë kështu m'u duk e rrezikshme. Meqë nuk gjeta dot ide të tjera më të mira, rrija tërë ditën në dhomën time dhe arratinë e realizoja me mend. Guxoja ta kapja fshatarin, ia recitoja gënjeshtrën për prindërit e vdekur, i përgjerohesha të më merrte me vete, të më bënte bir për shpirt, siç kisha dëgjuar të thuhej në raste të tilla. Fshatari qëllonte

njeri shpirtmirë, më rrëmbente në krahë, më vendoste mbi samarin e gomarit e unë zhdukesha bashkë me të diku, përtej lumit. Do të qëndroja në arrati plot njëzet vjet. Pas njëzet vjetësh do të kthehesha në shtëpi, ku prindërit do t'i gjeja të plakur e ata do të më prisnin me lot në sy, të penduar për sjelljen e tyre. Ky ka qenë skenari im i parë sentimental, i pashkruar – unë ende s'kisha mësuar të shkruaja – me një motiv arratie që nuk u realizua kurrë. Përkundrazi, atë verë realizova një bëmë tjetër: një inspektim fshehurazi në dhomën e Profesorit. Kjo qe aventura ime më e madhe para se në shtator të hyja në shkollë.

Dua të saktësoj se në sytë e mi Profesori ishte një burrë gati i moshuar. Por nisur nga datëlindja e tij, që e gjeta vite më vonë në një libër, i bie që në atë kohë Profesori të ketë qenë vetëm tridhjetë e pesë vjeç. Libri ishte një përmbledhje vjershash, origjinale dhe përkthime. Duke i lexuar ndjeva një dëshirë për të qarë: kuptova se ai i përkiste një kategorie të brishtë, ai nuk mund të kishte mbijetuar në pyllin e egërsirave. Dhe më duket sikur kjo dëshirë për të qarë më ka mbërthyer për fyti prej kohësh, qysh kur guxova të hyja fshehurazi në dhomën e tij.

Ishte verë. Në të dy katet e shtëpisë ndodhesha vetëm unë dhe nuk e shpjegoj dot përse ndodhesha vetëm, ku kishin vajtur prindërit, përse s'më kishin marrë me vete dhe përse nëna plakë e Profesorit, e cila largohej rrallë, atë ditë se nga kishte shkuar. Heshturazi u vara nëpër shkallë. Zbrita majë gishtërinjve në sallonin e katit të poshtëm, ku qëndrova një copë herë me frymëmarrje të prishur. Pastaj i mëshova dorezës në derën e dhomës së

Profesorit. Për çudi ajo lëvizi dhe unë ngriva. Vetja m'u duk si një hajdut i kapur me presh në dorë. Hodha një hap, kapërceva pragun, hodha dhe një hap tjetër, vajta deri në mes të dhomës dhe, ndonëse e kuptoja se s'duhej të kisha frikë, zemra më rrihte fort. U ula në karrigen e Profesorit, para skrivanisë. Për një çast u drodha. Po sikur dikush të vinte syrin në vrimën e dërrasës sipër, në dhomën time, të më shihte ulur në karriken e Profesorit? Jo, thashë me vete, kjo është e pamundur. Dikushi jam unë, por tani unë ndodhem këtu.

Sendet e asaj dhome ishin të njohura për mua. Kërkimi te sirtarët e skrivanisë, gjithsej dy, doli pa sukses, që të dy ishin mbyllur me çelës. Kjo më shtyu të shkoja te dollapi i rrobave, në xhepin e ndonjë xhakete do të gjeja ndonjë çelës. Në vend të kësaj zbulova dy sende të papritura: një fustan nusërie me kurorë, dhe fotografinë e një gruaje.

Fustani ishte i gjatë, i bardhë, ishte vendosur midis kostumeve të Profesorit. Për të arritur te kurora m'u desh të merrja karrigen. Hipa lart, koka ime erdhi në nivelin e kokës së dollapit dhe nuk e pata të vështirë të tërhiqja kurorën. Profesori ka një nuse, thashë me vete. Dhe e vura kurorën në kokë. Kur kindat e vellos u varën poshtë, e hoqa. Jam djalë, arsyetova, nëse shokët e mi do të më shihnin kështu, do të më tallnin. E vendosa kurorën atje ku kishte qenë, sipër fustanit dhe u kujtova se qëllimi im ishte të gjeja ndonjë çelës. Futa duart nëpër xhepat e të gjitha xhaketave, derisa në xhepin e brendshëm të një palltoje gjeta atë, fotografinë e gruas.

Në të vërtetë, në fillim unë gjeta një medalion me zinxhir të hollë floriri, nga ata që më vonë mësova se

vareshin mbi gjoks. Nuk e dija ç'ishte ai send. Vura re se formohej nga dy kapakë dhe aty për aty provova t'i hapja. Kapakët u hapën. Në brendësinë e njërit prej tyre pashë fotografinë e gruas. Më saktë, pjesën rrumbullake me fytyrën e gruas, të prerë nga një fotografi. Duhet të jetë nusja e Profesorit, mendova. Ky qe një përfundim i logjikshëm. Vetëm kështu shpjegohej prania e atyre sendeve në dollapin e rrobave të Profesorit: e fustanit të nusërisë dhe e gruas në medalion. Si e vështrova një copë herë fotografinë, mbylla kapakët dhe medalionin e ktheva në xhepin e brendshëm të palltos. Hoqa dorë nga kërkimi i mëtejshëm i ndonjë çelësi. E vura karrigen në vend, dola nga dhoma, mbylla me kujdes derën pas vetes dhe majë gishtërinjve, pa shkaktuar as zhurmën më të vogël, u ktheva në dhomën time. Vështrimi i gruas së medalionit nuk më shqitej. Ishte një grua e re, shumë e bukur. Sytë e saj sikur më qortonin. Unë të pashë, sikur më thoshin ata sy, të pashë!

Deri në shtator, kur fillova shkollën, nuk ndodhi asgjë tjetër e veçantë. Ndodhi vetëm që njohuritë e mia për botën u pasuruan me një fjalë të re. Unë nuk ia dija kuptimin dhe kur e dëgjova, nuk mendova se ishte ndonjë ngjarje, aq më pak e veçantë. Një mbrëmje nëna i tha tim eti se nuk mund ta duronte më këtë jetë, i kishte ardhur në majë të hundës dhe ai duhej të bëntë çmos të largoheshim prej këndej, të vendoseshim në një shtëpi tjetër. Këtu as kushërinjtë nuk guxonin më të vinin, prej kohësh vizitat e miqve qenë prerë. Me këtë rast ajo përdori fjalën survejim. Tha se nuk e duronte dot më këtë jetë nën survejim. Desha ta pyesja ç'do të thoshte fjala survejim, por nëna ishte tepër e nervozuar. Ja nga të qarat e Brunildës, ja

ngaqë babai kishte pirë. Po ndoshta për shkak  të asaj që ajo e quajti jetë në survejim. Si zakonisht në raste të tilla, nëna më urdhëroi të shkoja në dhomën time. Dhe si zakonisht unë iu binda. U mbylla në dhomë, por kësaj radhe mendja ime vazhdoi të punonte. Të përqaste faktet. Pra, nënës i kishte ardhur në majë të hundës, kërkonte të largoheshim nga kjo shtëpi. Më tej ngecesha të fjala survejim, si një mizë në rrjetën e merimangës. Qoshet e murit rrethues të oborrit ishin plot rrjeta merimangash ku binin miza. Një herë unë zura një mizë dhe e hodha me dorën time në rrjetë, por nuk pashë të dilte ndonjë merimangë për ta ngrënë. Duke u ngatërruar në fijet e këtij arsyetimi, erdha në përfundimin se gjithçka duhej të lidhej me Profesorin, pavarësisht kuptimit të fjalës survejim. Askush nuk e donte Profesorin. Të gjithë i trembeshin. Përveç meje. Ndoshta, mendova, është edhe dikush tjetër që nuk trembet prej tij: gruaja e medalionit. Bëra një përpjekje për t'ia kujtuar fytyrën. Mbaja mend se ajo ishte shumë e bukur dhe për disa ditë vështrimi qortues i syve të saj nuk më qe ndarë. Megjithatë, arsyetova, nëse ajo nuk ka frikë si të tjerët, pse nuk vjen ta shohë Profesorin?

Është çasti ta ringjall atë grua. Ose ta nxjerr nga ëndrra. Në të dyja rastet është njëlloj si të kërkoj pjesët e vdekura të vetvetes. T'i gjej, t'i prek me dorë. T'i zhvarros e t'i varros përsëri. Dhe të bëj çmos që në këtë ceremoni zhvarrimi dhe rivarrimi të fëmijërisë së hershme, të sillem denjësisht. Në këtë pikë ka rrezik të mbytem sapo të nxjerr nga goja fjalën e parë: kisha rënë në dashuri me atë grua. Deri këtu nuk ka ndonjë gjë për t'u habitur, unë kisha rënë një herë në dashuri,

me nënën time. Por në rastin e dytë qe ndryshe. Atë grua nuk e njihja, nuk e kisha takuar kurrë. Unë kisha rënë në dashuri me portretin e saj, mbyllur në kapakët e një medalioni. Një ditë ajo doli prej andej. Kur u ndodh përballë meje, mendova se isha në ëndërr. Desha ta pyesja përse e kishte braktisur medalionin, ç'kërkonte këtu, përpara tridhjetë palë syshë që e shihnin në heshtje, siç e shihja edhe unë, pa e marrë dot veten, pa e besuar vërtet se nuk isha në ëndërr, se isha në orën e parë të mësimit, në klasën e parë, dhe gjëja e parë që mësova ishte emri i saj. Tha se quhej Liza.

Për mungesë dhomash në shkollë, nxënësit e fillores, pra edhe ne të klasave të para, mësimin e zhvillonim pasdite. Ishte koha kur zakonisht në shtëpi, si drekoja, duhej të bëja gjumin e vapës. Ky lloj gjumi ishte për mua një torturë e imponuar nga nëna. Nuk flija, është e pamundur të të zërë gjumi kur dëgjon të tjerët që luajnë në rrugicë. Prandaj nuk e shpjegoj dot sesi ndodhi që në orën e parë të mësimit mua më zuri gjumi.

Gruan e medalionit unë e njoha sapo e pashë, kur u vumë në radhë përpara shkollës. Dhe u fsheha pas trupit të një nxënësi, aq e fortë qe përshtypja ime se edhe ajo do të më njihte. Kjo ndjesi nuk m'u shqit as në klasë. Gruaja qëndroi në katedër, hapi regjistrin dhe zuri të na lexonte emrat. Nga frika isha strukur në një bankë në fund të klasës. U luta më kot që emri im të mos figuronte në regjistër. Ajo e lexoi, unë u ngrita në këmbë pa guxuar të flisja dhe prita të më mbërthente me atë vështrimin qortues. Pak a shumë kështu ndodhi. Gruaja e medalionit i shkëputi sytë nga regjistri, i brodhi nëpër klasë, derisa i nguli tek

unë. Pështjellimi im u bë i plotë kur ajo më kërkoi të lëvizja, të dilja përpara. Lëviza, vajta drejt saj. Tani, thashë me vete, ajo do t'u tregojë të gjithëve se jam hajdut, jam futur fshehurazi në dhomën e Profesorit, kam rrëmuar nëpër sirtarë, kam trazuar nëpër xhepat e rrobave të tij. Më hipi t'ua mbathja, të dilja nga klasa, të zhdukesha nga sytë këmbët. Nuk bëra asgjë nga këto. Ajo më vuri dorën në kokë, më shpupurisi flokët. Tha se unë isha memec dhe si më trupvogli, më takonte të ulesha në bankën e parë. I terrorizuar, u ula në bankën e parë. Dhe m'u desh një farë kohe të qetësohesha, të mendoja se isha trembur kot. Vështrimi i saj nuk ishte qortues. Vështrimin qortues ajo e kishte lënë të mbyllur brenda kapakëve të medalionit, në xhepin e palltos së Profesorit. Gjumi duhet të më ketë zënë kur po përpiqesha të përfytyroja se çdo të bënte Profesori po të futesha edhe njëherë fshehurazi në dhomën e tij dhe t'ia vidhja vërtet medalionin me portretin e gruas. Kjo është arsyeja që unë vazhdimisht dyshoj nëse takimi me të ka qenë i ëndërrt, apo ajo doli nga ëndrra për të më shoqëruar një copë rruge të shkurtër.

Nuk kishte asgjë të ëndërrt. Në një nga ato ditë, tek zbrisja shkallët për të vajtur në shkollë, Profesori m'u shfaq në pragun e dhomës së tij. Në dorë mbante një zarf. Ai më buzëqeshi dhe me zë të ulët më pyeti nëse mund t'ia jepja mësuese Lizës atë zarf. Pranova menjëherë. Dhe veprova siç më porositi: zarfin ia dorëzova të interesuarës duke u kujdesur që të mos më shihte askush. E që nga ai çast i mbusha mendjen vetes se mua dhe Lizën na lidhte një ndjenjë bashkëfajësie. Ajo e dinte se unë kisha hyrë si hajdut

në dhomën e Profesorit, kisha futur duart në sirtarët dhe xhepat e rrobave të tij. Unë e dija se portreti i saj gjendej brenda kapakëve të një medalioni, në një dollap ku ruhej një fustan i bardhë nusërie me vello. Për mua do të ishte fundi i botës nëse Liza do të ma nxirrte në shesh të fshehtën. Për Lizën do të ishte fatkeqësi nëse ato që kisha parë në dhomën e Profesorit do t'ua tregoja të tjerëve. Unë nuk e kuptoja pse për Lizën diçka e tillë do të ishte fatkeqësi, megjithatë, kur ajo ma kërkoi, iu betova se gjithçka do ta mbaja të ndrydhur brenda vetes. Mundet që kur i jam betuar, të mos jem shprehur me këto fjalë. Vështirë të isha në gjendje të shprehesha me këto fjalë. Por, sido që të jem shprehur, thelbi mbetet i njëjtë, midis nesh u vendos një marrëveshje. Pas kësaj marrëveshjeje vjen dhe fundi. Unë jam i vetmi që mund të sjell një dëshmi të atij fundi.

Gjithçka nisi me një incident. Po e quaj incident të marrësh. Çdo lagje kishte të marrët e vet. Unë mbaj mend dy prej tyre. Njëri ishte Lymi i Tutit. Në të vërtetë, Lymi i Tutit banonte në një lagje tjetër, diku nga materniteti, por kalonte pothuaj çdo ditë nga rrugica jonë. Ishte shtatshkurtër, kullonte nga zhelet dhe jargët. Sapo dukej në rrugicë, atij i vërsuleshin qentë dhe fëmijët. Lymi shtyhej përpara pa u shqetësuar, u përgjigjej vetëm qenve. Ai mblidhte gjithandej hekurishte, kusi të ndryshkura, kanoçe, teneqera dhe thuhej se rreth kasolles së tij kishte ngritur një mur të lartë me lloj-lloj hedhurinash të tilla. Meqë nuk ishte agresiv, fëmijët e shoqëronin deri në dalje të rrugicës me të tallura. Unë nuk i vajta prapa ndonjëherë, mjaftonte pamja e jargëve të tij që të më vinte për të vjellë. Po të mos përmend erën

e keqe. Ngado që shkonte, ai linte prapa një kutërbim të tmerrshëm dhe ndoshta kjo është arsyeja që i vërsuleshin qentë. Lymi u hakërrehej, hidhej përpjetë dhe qentë i shmangeshin për një çast të trembur më shumë nga zhurma e përplasjes së teneqeve kur ai hidhej, sesa nga britmat e tij. Por Lymi ishte i qetë, shihte punën e vet. Ai nuk ka të bëjë me incidentin në fjalë. Me incidentin në fjalë lidhet një i marrë tjetër, banor i lagjes. Ai njihej nga të gjithë si Gimi i Tatës. Ose Gim Budallai.

Zakonisht Gim Budallai rrinte para hyrjes së dyqanit të bukës. Në atë kohë buka ishte me triskë, kurse Gim Budallai ndihej vazhdimisht i uritur. Ishte një tip eshtërmadh, me kokën stërgjatëshe si kungull, me fytyrë të tultë e vështrim të vëngër. Të gjithëve që dilnin nga dyqani u kërkonte bukë, ai kërkonte pangopësisht, me një pamje ankthi që të fuste frikën. Ndryshe nga Lym i Tutit, Gim Budallai ishte agresiv. Atë nuk guxonin ta ngacmonin as fëmijët, as qentë. Kur ndonjëri qorrollepsej ta ngacmonte, Gimi tërbohej, e ndiqte me vrap, i gjuante me ç't'i binte në dorë. Disa thoshin se Gimi i Tatës, gjithsesi, nuk duhej të ishte aq budalla. Ai dinte diçka thelbësore, vlerën e parasë. Për pak monedha, me të cilat mund të shkonte në ëmbëltore, të blinte ndonjë hashure, ai ishte gati të jepte një shfaqje të jashtëzakonshme: ulte pantallonat dhe nxirrte penisin publikisht. Kjo ndodhte kur maskarenjtë e lagjes – siç kishte të marrët, çdo lagje kishte edhe maskarenjtë e vet – për qejf ose për të turpëruar ndonjë vajzë, e nxisnin duke i kënduar refrenin: Gimi, tregoja kësaj për dhjetë lekë! Atëherë të pranishmit mund të shihnin penisin e stërmadh të Gimit.